

**AKT THEMELIMI  
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ARFESP" - Sh.P.K.**

Unë , **Pllumb Puci**, i biri i Femiut, lindur me **22.07.1975** në Venisht/Dibër, banues në Venisht/Dibër", Njësia Administrative **Sllove/Dibër**, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no.H50722002V**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **Sot me datë 16.01.2018**

**V E N D O S A**

**Neni 1**

Të themeloj një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : **"ARFESP" - Sh.P.K.**

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

**Neni 3**

**Shoqëria e ka SELINË në** fshatin Venisht, Njësia Administrative Sllove, Bashkia/Dibër në adresën : **Lagja "PUCE" , Rruga "Venisht-Sllovë", Ndërtesa Nr.07, qendër/Venisht.**

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

**Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, **mbi 15 vjet.**

**Neni 5**

Kapitali Themelor i Shoqërisë do të jetë **100 000 Lek (Njëqindmijë lek).**

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, **Pllumb Puci.**

Ortaku i Vetëm **Pllumb Puci, zotëron 100 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga

**1 pjesë e vetme (Një kuotë) me vlerë nominale prej 100 000 Lek (Njëqindmijë lek).**

**Neni 6**

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm. Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

**Neni 7**

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

**Neni 8**

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :**

a) Në fushën e ndërtimit në kategoritë e mëposhtme: Punime gërmimi në tokë, ndërtime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash, rrugë, autostrada, mbikalime, vepra kullimi e vaditje, ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, linja të TN e T/Mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Punime për prishjen e ndërtimeve, impiante hidrosanitare e kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre, impiante ngritëse dhe transportues (shkallë lëvisëse, transportues). Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik e xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Ndërtime parafabrikat

*Pllumb Puci*  
*Puci*

beton/arme, struktura metalike dhe druri. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Impiante dhe linja telefonie e telekomunikacioni. Impiante të brendëshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV-ni etj., Punime topogjeodezike. Punime nëntoksore, ura e vepra arti. Diga dhe tunele hidroteknike. Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike. Punime të inxhinjerisë së mjedisit. Punime strukturore speciale, shtresa dhe mbistruktura speciale. Punime mbi shina dhe traversa. Pastrimi i ujrave, liqenore dhe lumore. Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimi i tij. Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Sistemet kundra zhurmës në infrastrukturë. Shpime gjeologo-inxhinjerike, puse e shpime për ujë. b) Në fushën e tregtisë në drejtimet e mëposhtme : Import-Eksport, tregtimi i artikujve të ndryshëm i të gjitha llojeve me shumicë e pakicë. Tregtimi i artikujve të ndryshëm industrialë. Tregtimi i artikujve të ndryshëm ushqimorë. Tregtimi i artikujve të ndryshëm bujqësor e blektoralë. Tregtim fruta-perimeve, Tregtim automjetesh të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe tregtimi i pjesëve të këmbimit për to. Tregtim paisjesh elektroshhtëpiake, elektronike, higjeno-sanitare, prodhime qeramike, prodhime të artizanantit etj. Tregtim bimësh mjeksore e eterovajore, plehrash kimike, pesticidesh, konfeksioneve e tekstile, artikujve të farmaceutikës e kozmetikës, këpucë të çdo lloji, galanteri dhe artikuj lëkure. Tregtim pijesh alkolike dhe jo alkolike. Hapje autoshkolle, hapje pike lavazhi dhe servisi për automjete. Tregtim me shumicë e pakicë të karburanteve. c) Në fushën e transportit, në drejtimet e mëposhtme : Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda e jashtë vendit, transport pasagjerësh brenda e jashtë vendit, transport materialesh ndërtimi e lënde të para brenda e jashtë vendit. d) Në fushën e shërbimeve. Hapje e shfrytëzimit hotelesh, motelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendra pushimi e kurative. Punime të duraluminit e tregtimi i tyre. Punime druri, tregtim prodhimesh të ndryshme druri si : orendi, dyer, dritare, etj, Përmirsimi i pyjeve, shfrytëzimi, përpunimi dhe tregtimi i lëndës drusore, mbrojtja dhe përmirsimi i livadheve e kullotave, mbrojtja e pyjeve nga zjarri e dëmtuesit, përmirsimi i florës e faunës së zonave. Veprimtari në studim, projektim dhe zbatim punimesh, ndërtim dhe meremetim i veprave për sigurimin e ujit të pijshëm në kullota e livadhe. Punime të ndryshme alumini, llamarine, punime ulluqesh e të ngjashme dhe tregtimi i tyre. Punime hekuri, lyerje dhe tregtimi i tyre. Shtrime pllakash, lyerje ndërtesash. Tregtim i të gjithë produkteve të hekurit, aluminit dhe llamarinës.

#### **Neni 9**

Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995”Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Neni 10**

Ortaku i Vetëm i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 11**

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

#### **Neni 12**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

*Shkruar dhe  
shprehur*

**Neni 13**

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të shoqërisë.

**Neni 14**

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

**Neni 15**

**Organet e Shoqërisë “ARFESP” - Sh.P.K. janë :**

- Asambleja e Ortakëve (Ortaku i Vetëm)

- Administratori/ët e Shoqërisë

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

**Administrator** i shoqërisë do të jenë **Z. Pllumb Puci.**


Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.**

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje vlerë të njëjtë me origjinalin.

**THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE“**

**“ARFESP” - Sh.P.K.**

**Pllumb Puci.**



**Peshkopi, me 16.01.2018**